




## REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHQIPTARIT

Nr. 277/2 Prot.

Tiranë, më 26 / 02 / 2021.



AKADEMIA E STUDIMEVE  
ALBANOLOGJIKE

Nr. 88 Prot.

Tiranë, më 26 / 02 / 2021

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

dhe

AUTORITETIT PËR INFORMIM MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË  
SHQIPTARIT

Akademia e Studimeve Albanologjike (më poshtë ASA) përfaqësuar nga akademik prof.dr.  
Marenglen Verli  
dhe

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (më poshtë AIDSSH)  
përfaqësuar nga Kryetarja, Znj. Gentiana Sula;

Nisur prej interesit të përbashkët të dy institucioneve, palët bien dakord të lidhin këtë  
Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "Marrëveshja").



## Neni 1

### Objekti

Objekti i kësaj **Marrëveshjeje** është institucionalizimi i marrëdhënieve për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të mbështetjes së kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë represive të regjimit komunist dhe veçanërisht të ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve, veçanërisht në formimin universitar të thelluar të studentëve.

## Neni 2

### Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj **Marrëveshjeje**, Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Statuti i ASA.

## Neni 3

### Sfera e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet të dy institucioneve do të përfshijë:

- a) fushat akademike dhe të hulumtimit e publikimit me interes të përbashkët, bazuar në parimet e barazisë dhe reciprocitetit;
- b) shkëmbimin e shërbimeve dhe të ekspertëve, stafit akademik dhe të kërkuesve të instituteve përkatëse me dokumentacionin arkivor të AIDSSH-së, në kuadrin e veprimtarive kërkimore shkencore, botimeve, etj.;
- c) nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, të edukimit qytetar dhe për të zhdukurit, në kuadër të veprimtarisë që AIDSSH ushtron me ligj;
- d) nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare, tryeza, studime, botime, intervista e dokumentarë në fusha me interes të dyanshëm);
- e) shkëmbimin e literaturës shkencore, statistikave, raporteve periodike, botimeve përkatëse;
- f) hulumtimin reciprokisht të arkivave mbi bazën e legjislacionit në fuqi;
- g) bashkëpunimin e dedikuar me institutet e ASA, duke shfrytëzuar ekspertizën përkatëse, sa i takon studimeve historike, shoqërore, kulturore, etj., të periudhës 1944-1991, edhe në trajtim enciklopedik, të lidhur me përndjekjen në komunizëm, format e opozitarizmit dhe kundërshtisë me regjimin, figurave të mirënjohura intelektuale, përvojave dhe proceseve të ekspertizës të antropologjisë dhe arkeologjisë, sa u takon të zhdukurve në komunizëm, etj.,

## Neni 4

### Pronësia intelektuale

Të gjitha pronat intelektuale (botime, studime, intervista, dëshmi, filma, etj.) të zotëruara nga secila palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e palës që i ka në pronësi.



Pronësia intelektuale e krijuar si rezultat i bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë pronësi e përbashkët e të dyja palëve.

Palët i japin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet (në çfarëdo lloj forme qofshin) në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi dhe planeve vjetore të shkëmbyera. Në çdo rast, secila palë do të përdorë materialet e palës tjetër duke cituar burimin e informacionit.

## Neni 5

### Koordinimi mes palëve

Të dy institucionet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve financiare dhe të potencialit njerëzor të disponueshëm nga secili institucion.

## Neni 6

### Afati i Marrëveshjes

- Çdo nen i kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të dy institucioneve.
- Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur për vitet pasardhëse, kur të dy institucionet janë dakord për këtë. Mosrinovimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga pala e interesuar të paktën 3 muaj përpara përfundimit të saj.

Për

**Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet  
e ish-Sigurimit të Shtetit**

Për

**Akademinë e Studimeve Albanologjike**

**KRYETARJA E AUTORITETIT**

**Znj. Gentiana Sula**



**REKTORI**

**Akademik prof. dr. Marenglen Verli**

